

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Politika: Kërkohen Verifikime të së Kaluarës për Vullnetarët

QELLIMI

Të qartësohet pozicioni i Drejtorisë Arsimore në kërkesën për verifikimin e të Kaluarës për prindërit dhe vullnetarët e komunitetit.

PERCAKTIMET

Termi "Vizitor" do të përfshijë të gjithë personat të cilët vullnetarisht marrin pjesë në takime të ndryshme, udhëtime me shkollën, ose programe në ose për shkollën, në një rast ose me raste. Vizitorët nuk do të përfshihen në aktivitete, të cilat i lejojnë ata të jenë pa mbikëqyrje, pa drejtim, pa monitorim, ose në kontroll të fëmijëve.

Termi "Prind Vullnetar" do të përfshijë çdo prind/kujdestar të një nxënësi të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, i cili punon vullnetarisht me kohë të plotë, me kohë të pjesëshme, ose periodikisht për një periudhë të gjatë kohore (më shumë se 60 ditë) në, ose për shkollën, por nuk është i punësuar, kontraktor, ose nxënës i Drejtorisë.

Termi "Vullnetar jo-Prind" do të përfshijë çdo person, i cili punon vullnetar me kohë të plotë, me kohë të pjesëshme, ose periodikisht për një periudhë të gjatë kohore (më shumë se 60 ditë) në, ose për shkollën, por nuk është i punësuar, kontraktor, ose nxënës i Drejtorisë dhe nuk është gjithashtu Prind/Kujdestar i një nxënësi të Drejtorisë.

Termi "Vullnetar" do të referohet për të dy rastet, Prind vullnetar dhe Vullnetar-jo Prind.

POLITIKA

Vizitorëve nuk u kërkohet verifikim i pastërtisë të së kaluarës për aktivitete kriminale

Prindi Vullnetar duhet të jetë i pastër nga dy verifikime të të kaluarës:

- Rekordet për Historinë Kriminale nga Shteti i Pensilvanisë
- Raporti për Abuzimet me Fëmijët

Shënim: Drejtorja nuk kërkon nga Prindi Vullnetar të marrë verifikim të së Kaluarës nga FBI. Megjithatë, në rast se nga dy kërkesat e para rezultojnë ndonjë dënim kriminal, Prindit Vullnetar do t'i kërkohet të paraqesë edhe Verifikim të së Kaluarës nga FBI.

Vullnetarët jo-Prind duhet të kenë tre verifikime të pastra të së kaluarës:

- Rekordet për Historinë Kriminale nga Shteti i Pensilvanisë
- Raporti për Abuzimet me Fëmijët
- Verifikim i të Kaluarës nga FBI. (Vullnetarët e Rinj, është efektive nga data 1 Janar 2008)

Personat me ndonjë dënim kriminal serioz (sipas përcaktimit të Proçedurës) pesë vitet e para, pas datës së proçedimit të raportit, do të ndalohen të shërbejnë si Vullnetarë.

Në rastet me të kaluar të pastër, Drejtori ka të drejtën e marrjes së vendimit, nëse një person mund të shërbejë si vullnetar në shkollën e tij/saj.

Vullnetarët Perspektivë mund të punojnë vullnetarisht në ose për një shkollë paraprakisht, në pritje të Verifikimit të së Kaluarës, vetëm nën konditat e mëposhtme:

1. Ata paraqesin një kopje të formularit të kërkesës për verifikimin e të kaluarës te Administratori i Drejtorisë;
2. Ata bëjnë betim, ose pohojnë me shkrim nën betim, se nuk kanë asnjë histori kriminale, që mund t'i ndalojë ata që të jenë vullnetarë; dhe
3. Ata nuk do të përfshihen në aktivitete të cilat i lejojnë ata të jenë pa mbikëqyrje, pa drejtim, pa monitorim, ose në kontroll të fëmijëve.

19 Dhjetor 2007